BASHKË KRIJOJMË ARDHMËRI
SKZH 2022-2042

MEKANIZMAT DHE INSTRUMENTET INOVATIVE PËR FINANCIMIN DOKUMENTEVE STRATEGJIKE NACIONALE

Shkup, dhjetor 2022

P Ë R M B A J T J A

1. HYRJE 4
2. KONTEKSTI 6
2.1. Resurse të kufizuara buxhetore dhe hapësirë fiskale e reduktuar 6
2.2. Plani për përshpejtimin e rritjes (vitet 2022-2026) 7
2.3. Nga Plani për rritje të përshpejtuar në Strategjinë nacionale për zhvillim 9
3. BURIMET INOVATIVE DHE MEKANIZMAT PËR FINANCIMIN E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM 10
3.1. Riklasifikimi bashkëkohor i financave 10
3.2. Burimet e financimit 12
3.2.1. Burimet vendore publike të financimit 13
3.2.2. Burimet e huaja publike të financimit 14
3.2.3. Burimet e brendshme vendore 15
3.2.4. Burimet private ndërkombëtare 15
3.3. Mekanizmat dhe strukturat tradicionale dhe inovative të financimit 16
3.4. Instrumente inovative të financimit 17
3.4.1. Taksat inovative 17
3.4.2. Mbështetje inovative e sipërmarrjes 19
3.4.3. Fondet inovative të garancisë 22
3.4.4. Produkte dhe shërbime inovative bankare 24
3.4.5. Qasjet inovative në bursë 26
3.4.6. Rregullim inovativ bankar 26
3.4.7. Inovacione në tërheqjen e IHD 27
3.4.8. Përdorimi inovativ i financave të diasporës 29
3.4.9. Fletëobligacione inovative 31
3.4.10. Financa inovative lokale 36
3.4.11. Partneritete inovative publike private 37
4. ANALIZA KRAHASUESE E PËRVOJAVE TË FINANCIMIT TË STRATEGJIVE NACIONALE ZHVILLIMORE NË EVROPËN JUGLINDORE 40
Republika e Kroacisë 40
Republika e Serbisë 41
Republika e Malit të Zi 41
5. HAPAT E ARDHSHME 42

Aneksi nr. 1. Institucionet financiare ndërkombëtare dhe nacionale që janë aktive në rajonin e Ballkanit Perëndimor 45
Literatura e përdorur 46

1. HYRJE

Nocioni "financimi inovativ i zhvillimit" u përdor për herë të parë në fillim të mijëvjeçarit të ri (UNDP, 2012). Financimi inovativi referohet të gjithë mekanizmave dhe iniciativave, të cilat sigurojnë financim për përmbushjen e Agjendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm. Financimi inovativ i zhvillimit përkufizohet gjithashtu si zbatim jo tradicional (jo konvencional) i "parimit të solidaritetit, partneriteteve publike-private dhe mekanizmave përshpejtues, të cilët: (i) mbështesin mbledhjen e mjeteve duke përdorur burime të reja dhe duke angazhuar investitorë jashtë dimensionit financiar të transaksioneve, si partnerë dhe palë të interesuara në zhvillim; ose (ii) jep zgjidhje financiare për problemet e zhvillimit në praktikë" (World Bank 2009).

Çfarë mbulon financimi inovativ? Financimi inovativ zakonisht përfshin: (1) instrumente të reja financiare për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm; (2) një kombinim i ri i instrumenteve financiare ekzistuese; (3) përfshirja e partnerëve të rinj të zhvillimit (p.sh. fondet e reja të kapitalit sipërmarrës); (4) inovacionet në mënyrat se si përdoren mjetet e mbledhura; (5) fokus i ri dhe fusha të reja komplementare të projekteve. Financimi inovativ i zhvillimit duhet të sigurojë një plotësim (ndonjëherë edhe një zëvendësim) të burimeve tradicionale dhe mekanizmave të financimit.

Perspektiva të ndryshme të inovacionit. Në një ekonomi globale që lëviz me shpejtësi të ndryshme, ajo që konsiderohet si instrument financiar *tradicional* në ekonomitë e zhvilluara të tregut, ende mund të konsiderohet *inovative* në ekonomitë në tranzicion dhe ekonomitë në zhvillim. Për shembull, fletëobligacionet komunale janë një instrument financiar konvencional në shumë ekonomi të zhvilluara, megjithëse ato nuk janë përdorur si instrument financimi nga komunat në Maqedoninë e Veriut. Një argument i ngjashëm mund të përdoret për instrumentet financiare të papërdorura, të tilla si faktoringu. Është i pranishëm në praktikë, por zbatimi i tij është jashtëzakonisht i vogël.

Qëllimi i financimit inovativ. Qëllimet kryesore të financimit inovativ janë të gjenerojë mjete shtesë për zhvillim duke përdorur burime të reja të financimit, të përmirësojë efikasitetin e të ardhurave financiare dhe të bëjë financat më të orientuara drejtë rezultateve. Kur vlerësohet rëndësia e financimit inovativ, duhet të merret parasysh jo vetëm shuma absolute e mbështetjes financiare, por edhe - më e rëndësishmja - efektet multiplikative ose efektet e leverixh. Kështu, për shembull, plani i Junker për Evropën (i lançuar nga Komisioni Evropian gjatë mandatit të Zhan Klod Junker) siguroi mbështetje financiare për projekte të arsyetuara ekonomikisht përmes garancive në vlerë prej 16 miliardë euro nga BE-ja dhe 5 miliardë euro nga Banka evropiane e investimeve(BEI). Me mobilizimin e kapitalit privat shtesë, plani parashikonte investime të përgjithshme në vlerë prej 315 miliardë eurosh. Efekti multiplikativ ose efekti i leverixh konsiston në faktin se çdo euro e parasë publike të investuar do të gjenerojë investime të përgjithshme prej 15 euro, ose një leverixh prej 15.[1]

Financa inovative dhe të kombinuara. Financimi inovativ në masë të madhe përputhet me konceptin e financimit të kombinuar (blended finance), i cili parashikon kombinime të ndryshme të burimeve publike dhe private të financimit të projekteve investuese në fushat prioritare. Financimi i kombinuar është përdorimi i kapitalit katalitik (përshpejtues) nga burime publike ose

[1]Një vlerësim më konzervativ i Société Générale është gjeture leverixh ndërmjet 5 dhe 7.

filantropike me qëllim të rritjes të investimeve private dhe publike dhe arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë, qeveritë, institucionet ndërkombëtare, investitorët të cilët kanë disponim filantropik dhe palët e tjera të interesuara po këmbëngulin që (i) të zvogëlojnë rrezikun e investimit ose (ii) të përmirësojnë kthimet e përshtatura sipas rrezikut. Duke pasur parasysh përqendrimin në rritje në qëndrueshmëri, financat inovative shoqërohen gjithnjë e më shumë me konceptin e financave të qëndrueshme, të cilat kthehen në një trend kryesor në tregjet e kredisë.

Grafiku nr. 1. Fuqia e leverixhit së burimeve vendore dhe të huaja të financimit



Burimi: European Council and European Investment Bank (2022).

Nga aspekti i shkallës të përdorimit të instrumenteve të financimit dallojmë:

- instrumentet tradicionale ose konvencionale: tatimet tradicionale dhe të ardhurat jotatimore, grantet, kreditë e mbështetjes buxhetore, kreditë e projekteve, fletëobligacionet klasike të qeverisë, bonot e thesarit.
- instrumentet financiare inovative: tatimet inovative (p.sh. taksa e karbonit), fletëobligacionet e gjelbërta, fletëobligacionet gjinore, fletëobligacionet sociale, fondet hibride për të mbështetur investimet strategjike, një spektër i gjerë opsionesh për financim të kombinuar, etj.

Një hendek i madh në financim për të realizuar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Kombet e Bashkuara vlerësojnë se financimi vjetor i nevojshëm për të përmbushur Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (Sustainable Development Goals, DGs) deri në vitin 2030 është pothuajse 2,9 trilion dollarë, ose 2,8 herë më shumë se financimi aktual i vlerësuar për objektivat në vlerë prej 1,4 trilionë dollarë amerikanë, nga burime vendore dhe të huaja. Agjenda 2030 përfshin 17 Objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm dhe 230 synime të përcaktuara saktësisht, të cilat duhet të financohen nga subjektet publike dhe investitorët privatë.

Financat inovative kanë potencialin për të ulur hendekun financiar. Shtetet anëtare të OKB-së arritën një konsensus mbi rëndësinë e shpërndarjes të mjeteve publike për tërheqjen e investimeve private në Konferencën e tretë ndërkombëtare për financimin zhvillimor në vitin 2015 në Adis Abeba (Addis Ababa Action Agenda, AAAA). Nga kjo konferencë ftohen jo vetëm qeveritë, por edhe bizneset, sektori joqeveritar dhe individë që të përfshihen në realizimin e Planit për veprim. Një iniciativë e ngjashme, e quajtur *Maksimizimi i financave për zhvillim*, tashmë është rritur në një qasje të re të Bankës Botërore, përmes së cilës të gjitha burimet e financimit,

ekspertizës dhe zgjidhjeve për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm në vendet në zhvillim dhe ekonomitë në tranzicion kombinohen dhe multiplikohen sistematikisht.

Në të njëjtën kohë, është e një rëndësie të veçantë të theksohet se Mekanizmat dhe instrumentet inovative të financimit nuk përjashtojnë në asnjë mënyrë burimet dhe instrumentet tradicionale të financimit. Kështu, për shembull, instrumentet financiare inovative nuk mund të zëvendësojnë kapacitetin e pamjaftueshëm për të aplikuar dhe marrë grante nga Bashkimi Evropian, të disponueshme përmes Instrumentit për asistencën e para-aderimit (IPA), Instrumentit për asistencën e para-aderimit dhe zhvillimin rural (IPARD), Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME), Evropa Kreative, Erasmus+, Horizont 2020 (Horizon 2020) dhe shumë të tjera. Financimi inovativ ndonjëherë mund të sigurojë zëvendësimin e burimeve tradicionale dhe mekanizmave të financimit. Për shembull, lëshimi i një fletëobligacioni të gjelbërt të qeverisë redukton nevojën për financim nëpërmjet një fletëobligacioni tradicional, të ardhurat e të cilit përdoren për dedikime të përgjithshme.

Ridrejtimi i burimeve të financimit drejt investimeve afatgjata dhe të qëndrueshme është thelbësor për të mbështetur kalimin në një ekonomi neutrale ndaj klimës, rezistente ndaj klimës, ekonomi efikase dhe të drejtë dhe, natyrisht, drejtë prioriteteve për zhvillim të qëndrueshëm (Komisioni Evropian, 2022).

Në pjesën vijuese do të përshkruhen aspektet përkatëse të kontekstit makroekonomik në miratimin e Strategjisë nacionale për zhvillim dhe në pjesën e tretë, do të elaborohen burimet e financimit, mekanizmat dhe instrumentet e inovacionit, të cilat përdoren për financimin e zhvillimit të qëndrueshëm në mbarë botën. Pjesa e katërt fokusohet në përvojat nga rajoni dhe pjesa e pestë i kushtohet hapave të mëtejshme.

2. KONTEKSTI

2.1. Resurse të kufizuara buxhetore dhe hapësirë fiskale e reduktuar

Financimi inovativ duhet të mbështesë investimet, konvergjencën reale ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Nevojat financiare të Ballkanit Perëndimor (WB6) për të nxitur investimet dhe zhvillimin e qëndrueshëm janë të mëdha. Qeveritë përballen me resurse të kufizuara buxhetore, veçanërisht për shpenzimet kapitale dhe veçanërisht në periudha krize shumëdimensionale apo shumështresore, si në vitin 2022) me hapësira të ngushta fiskale dhe nivele në rritje të borxhit publik. Qasja në financa është ende një problem për shumë ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme. Prandaj, financimi inovativ konsiderohet si një nga mekanizmat më të rëndësishëm për rritjen e investimeve në favor të zhvillimit të qëndrueshëm (Lukšić et al. 2022).

PBB për banor është vetëm 42% i PBB-së mesatare për banor të BE-27 në vitin 2021 (Grafiku nr. 2) dhe konvergjenca reale ekonomike duhet të përshpejtohet me një aktivitet më të fortë investues (Grafiku nr.3). Investimet bruto janë projektuar në një nivel të lartë, të cilat mund të realizohen me mjete dhe burime inovative të financimit.

Burimi: FMN (tetor 2022).

Njëkohësisht, ngushtohet hapësira fiskale dhe hapësira për huamarrje të mëtejshme (Grafiku nr. 4). Prej këtu rrjedh edhe ideja e përdorimit më efikas të parasë publike dhe futja e mjeteve dhe mekanizmave inovative për financimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Grafiku nr. 2. Borxhi publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2011-2027)



Burimi: IMF (2022).

Për sa i përket përmbushjes mesatare të Objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, progresi më i vogël vërehet në objektivin 13 Veprimi klimatik, dhe më i madhi në objektivat: 1 Mungesa e varfërisë dhe 8 Punë e denjë dhe rritja ekonomike dhe 10 Pabarazitë e reduktuara.

Grafiku nr. 3 Sfidat për Republikën e Maqedonisë së Veriut në përmbushjen e Objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm

Burimi: Sustainable Development Report (2022).

2.2. Plani për përshpejtimin e rritjes (vitet 2022-2026)

Burimet e kufizuara buxhetore dhe hapësira e reduktuar fiskale motivuan Qeverinë e Maqedonisë së Veriut për të dizajnuar Planin për përshpejtimin e rritjes (Growth Action Plan, GAP).

Duke futur mekanizma inovative të financimit dhe duke mobilizuar kapitalin privat, me çrast qëllimi përfundimtar është rritja e grupit të financave të qëndrueshme, mbështetja e investimeve të përgjithshme dhe përshpejtimi i rritjes ekonomike në afat të mesëm. Ai mundëson financim të koordinuar dhe të kombinuar nga subjektet publike dhe private në mënyra tradicionale inovative për të inkurajuar iniciativat e biznesit. Ai synon gjithashtu të përmirësojë mjedisin afarist, të inkurajojë reformat rregullatore dhe administrative dhe të vendosë standarde më të larta për përzgjedhjen, menaxhimin dhe vlerësimin e projekteve. Gjatë periudhës 2022-2026, Plani për përshpejtimin e rritjes synon të kombinojë burime publike në vlerën totale prej 4 miliardë eurosh, me kapital të mobilizuar privat prej 8 miliardë eurosh. Dy burimet (private dhe publike) janë planifikuar të bashkohen në një kornizë të përcaktuar të menaxhimit dhe një rrjet të institucioneve dhe agjencive për zbatim (siç janë Banka për zhvillim, Fondi për inovacion dhe zhvillim teknologjik, Drejtoria për zonat zhvillimore teknologjike dhe industrialee, etj.). Mekanizmi i transmetimit në Planin e përshpejtimit të rritjes 2022-2026 është paraqitur në grafikun nr. 6.

Grafiku nr. 4. Mekanizmi i transmetimit në Planin e përshpejtimit të rritjes 2022-2026



Instrumentet kryesore të Planit të rritjes së përshpejtuar 2022-26 janë:

- Të ardhurat buxhetore dhe ngarkimi me borxh:
  - Mekanizmi KAPEF (mekanizmi për rritjen e efikasitetit të shpenzimeve kapitale)
  - Fletëobligacioni zhvillimor
  - Fletëobligacioni i gjelbër
  - Fletëobligacion i indeksuar për inflacionin
  - Menaxhimi më i mirë i mjeteve publike
- Partneritetet publike private
- Koncesionet

- Financimi i kombinuar (Blended finance)
    - Fondi i garancisë
    - Fondi për efikasitet energjetik
    - Fondi për zhvillimin lokal dhe rajonal
    - Fondi për hulumtim dhe zhvillim
    - Instrumenti për financim të gjelbër
    - Fondi hibrid për transformimin e gjelbër dhe digjital për NVM (FITR)
    - Fondi hibrid strategjik për investimet e gjelbërta (TIRZ)
    - Fondi për kapitalin sipërmarrës (të rrezikshëm).
    - Fondi për rritjen e mjeteve financiare (Fund of Funds)
    - Platformat për financim të bashkuar (crowdfunding).

Për të siguruar zbatimin efektiv të planit për investim, pritet të vendoset struktura menaxhuese, e cili do të monitorojë të gjithë procesin e menaxhimit të projektit, duke përfshirë një sistem për informata kthyese për të përshpejtuar efektivitetin në aspekt të kohës. Struktura e qeverisjes bazohet në elementet ekzistuese institucionale me disa elementë të rinj që do të krijohen në faza të veçanta të ciklit të projektit, ku ka një vakum institucional. Ministritë dhe agjencitë qeveritare pritet të luajnë një rol udhëheqës në zbatim me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë për zhvillim aty ku është e nevojshme.

Gjendja e fondeve kapitale për banor të vendit tregon një hendek prej gati 50 për qind në raport me shtetet anëtare të BE-së të sapo pranuara (IMF, 2022). Vendi mbetet prapa në raport me BE edhe për sa i përket cilësisë së infrastrukturës. Prandaj, nëse zbatohet siç duhet, Plani për rritje të përshpejtuar mund të inkurajojë një aktivitet më të fortë investues dhe të nxisë rritjen ekonomike afatmesme. Megjithatë, ekzistojnë një sërë rreziqesh që lidhen me zbatimin e tij: (1) kriza shumështresore në vitin 2022 (pandemia aktuale, kriza energjetike dhe inflacioni dyshifror, i nxitur nga çmimet shumë më të larta të ushqimeve dhe energjisë), kriza e sigurisë në Evropë; (2) dobësimi i kapaciteteve administrative për shkak të daljes së kuadrit cilësor nga sektori publik; (3) mungesa e një strukture institucionale mbështetëse për të koordinuar financimin.

2.3. Nga Plani për rritje të përshpejtuar në Strategjinë nacionale për zhvillim

Plani për rritje të përshpejtuar (2022-2026) është një bazë e shkëlqyer fillestare për funksionalizimin e instrumenteve dhe mekanizmave të financimit të prioriteteve të zhvillimit të përcaktuara në dekadën e parë të Strategjisë nacionale për zhvillim. Plani për rritje të përshpejtuar mund të mbindërtohet në lidhje me:

- përpunimin më të detajuar të llojeve të veçanta të mekanizmave dhe instrumenteve të financimit, me një strukturë institucionale të përcaktuar qartë, që do t'i prezantojë dhe mbështesë ato, me afate të sakta dhe rezultate të pritshme;
- duke përcaktuar rradhitjen e futjes në faza të burimeve, mekanizmave dhe instrumenteve inovative
- shkalla e mbështetjes buxhetore në dispozicion për fusha të veçanta prioritare të zhvillimit të qëndrueshëm dhe
- vendosjen e një mekanizmi për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të zbatimit.

3. BURIMET INOVATIVE DHE MEKANIZMAT PËR FINANCIMIN E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Peizazhi financiar po bëhet gjithnjë e më kompleks, për sa i përket instrumenteve, mekanizmave dhe pjesëmarrësve të rinj dhe më kompleks. Burimet e financimit po bëhen më të larmishme, gjë që shton një dimension të ri të kompleksitetit. Për këto arsye, është e dobishme të sistemohen dhe të paraqiten instrumentet dhe mekanizmat inovative, të cilat janë në dispozicion të qeverive.

3.1. Riklasifikimi bashkëkohor i financave

Përveç fokusit tradicional në qëllimet ekonomike, financat bashkëkohore klasifikohen, sipas qëllimit të tyre, në financa që të drejtuara nga:

- mbrojtja e mjedisit jetësor (Environment), respektivisht financat e gjelbërta (ndryshimet klimatike, përdorimi i qëndrueshëm i ujit dhe materialeve, kontrolli i ndotjes dhe mbeturinave, ruajtja e biodiversitetit);
- sfera sociale (Sociale), respektivisht financa gjithëpërfshirëse (kushtet e punës, shëndeti dhe siguria, trajnimi i të punësuarve, të drejtat e njeriut, marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve,
- qeverisja (Governance) ose financat për menaxhim (qeverisja e korporatës, etika e biznesit, praktikat kundër korrupsionit, etika tatimore, privatësia dhe siguria e të dhënave).

Tre kategoritë ose fushat e fundit janë të bashkuara në termin anglisht "ESG financing" ose financimi i qeverisjes së mirë ekologjike, sociale dhe korporative.

Financimi i dekarbonizimit, financimi për përshtatje, financimi klimatik, financat e gjelbërta dhe financat e qëndrueshme janë koncepte të mbivendosura dhe të lidhura fort, që përfshijnë shumë mekanizma dhe instrumente tradicionale dhe inovative për financimin e Objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Instrumentet e reja financiare sigurojnë një mënyrë më efikase dhe efektive për qeveritë, partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit, sektorin privat dhe institucionet filantropike për të punuar së bashku për të ulur rezikun e projekteve të caktuara, për të përmirësuar raportet ndërmjet rrezikut dhe kthimit dhe për të mobilizuar kapital shtesë privat.

Grafiku nr. 7 jep një pasqyrë më të mirë të përfshirjes së ndryshme të koncepteve të veçanta financiare.

Financat e gjelbërta përbëhen nga financat për dekarbonizimin ose ekonominë me karbon të ulët, financat për përshtatjen dhe financat për aspekte të tjera të mbrojtjes së mjedisit jetësor. *Financat për dekarbonizimin* ose ekonomia "me karbon të ulët" përbëhet nga mbështetja financiare për kalimin e sistemeve energjetike drejt emetimeve më të ulëta të CO_2. *Financat për përshtatje* përfshijnë mbështetjen financiare për zgjidhjet e përshtatjes dhe realizimin e aktiviteteve në përgjigje të ndikimit të ndryshimeve klimatike që janë ende duke ndodhur, por edhe për t'u përgatitur për ndryshimet e ardhshme (UNEP Adaptation Gap Report, 2022). *Financat klimatike* janë të drejtuara nga "përpjekjet për të reduktuar emetimet e gazrave serrë dhe synojnë të reduktojnë rrezikueshmërinë, duke siguruar dhe rritur rezistencën e sistemeve të njeriut dhe ekosistemeve ndaj ndikimit negativ të ndryshimeve klimatike".

Financat gjithëpërfshirëse janë shërbime dhe produkte financiare të dedikuara që të ndihmojnë popullsinë me të ardhura të ulëta, respektivisht kategoritë e rrezikuara të qytetarëve.

Financat e qëndrueshme i referohen përfshirjes së aspekteve ekonomike, ekologjike, sociale dhe të qeverisjes kur merren vendime për investime afatgjata në aktivitete dhe projekte të qëndrueshme ekonomike.

Grafiku nr. 5. Përcaktimi i nocioneve kryesore



Burimi: UNEP (2016).

Vlen gjithashtu të theksohet Taksonomia e BE-së në investime të qëndrueshme (Rregullativa (BE) 2020/852 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 qershor 2020 që prezanton një kornizë për lehtësimin e investimeve të qëndrueshme dhe Rregullativën plotësuese (BE) 2019/2088). Taksonomia e re mbulon gjashtë fusha:

- zbutja e ndryshimeve klimatike
- përshtatja me ndryshimet klimatike
- përdorimi dhe mbrojtja e qëndrueshme e ujit dhe burimeve ujore
- tranzicioni drejtë një ekonomie qarkulluese
- parandalimi dhe kontrolli i ndotjes dhe
- mbrojtja dhe ripërtrirja e biodiversitetit dhe ekosistemeve.

3.2. Burimet e financimit

Burimet e financimit të zhvillimit të qëndrueshëm mund të ndahen sipas disa kritereve:

- Në varësi nga statusi i rezidentit nga subjektet që ofrojnë burime financimi, dallojmë burimet e financimit vendor dhe të huaj. Është e qartë se një ekonomi e vogël në tranzicion është e orientuar në mënyrë të pashmangshme drejt përdorimit të burimeve të jashtme të financimit për të inkurajuar investimet dhe konvergjencën reale ekonomike.
- Në varësi të faktit nëse subjektet që ofrojnë burimet e financimit kontrollohen nga shteti (ose shtetet), dallojmë burimet e financimit nga *subjektet publike dhe private*. Subjektet publike janë qeveritë, agjencitë qeveritare, institucionet financiare ndërkombëtare (duke përfshirë bankat multilaterale zhvillimore), bankat zhvillimore dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë zhvillimor, ndërsa subjektet private që ofrojnë financim janë bankat komerciale, fondet e investimeve, kompanitë e menaxhimit të fondeve pensionale, fondet me kapital të rrezikshëm dhe të ngjashme.
- Në varësi nga përdorimi i instrumenteve të financimit dallojmë: (1) instrumentet tradicionale ose konvencionale: tatimet tradicionale dhe të ardhurat jotatimore, grantet, kreditë për mbështetje buxhetore, kreditë e projekteve, fletëobligacionet klasike të qeverisë, bonot e thesarit. (2) instrumentet financiare inovative: tatimet inovative (p.sh. tatimi i karbonit), fletëobligacionet e gjelbërta, fletëobligacionet gjinore, fletëobligacionet sociale, fondet hibride për të mbështetur investimet strategjike, një spektër i gjerë opsionesh për financim të kombinuar dhe të ngjajshme.
- Në varësi nga kushtet në të cilat miratohen burimet e financimit, dallojmë: (1) financimin zhvillimor, pra burimet e financimit të siguruara nga institucionet publike dhe organizatat filantropike nga sektori privat ose joqeveritar. Të udhëhequra kryesisht nga përpjekjet për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, ato sigurojnë financim me kushte më të favorshme (financim koncesionar). (2) kapitali privat, i udhëhequr kryesisht nga motivi i përfitimit, i cili më shpesh insiston në sigurimin e burimeve të financimit në kushtet e tregut.

Tabela 1. Tipologjia themelore e burimeve të financimit

Lloji i subjekteve Statusi rezident	Publike	Private
Vendore	P.sh., Granti nga Fondi për inovacion dhe zhvillim teknologjik	Për shembull, kredi nga Banka Komerciale SHA Shkup
Të huaja	Për shembull, kredi nga Banka Botërore	P.sh., investimi nga Fondi evropian për Evropën juglindore

Sipas UN (2021), 76,7% e burimeve të financimit të Objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm ishin burime publike vendore, burimet private ndërkombëtare siguruan 12,5%, burimet private të vendore të financimit siguruan 6,3%, ndërsa burimet private ndërkombëtare sollën 4,5%. Burimet e ndryshme të financimit dhe rrjedhat financiare në ekonomi janë ilustruar në Grafikun nr. 8.

Grafiku nr. 6. Prezantimi i burimeve të financimit dhe rrjedhave financiare

Burimi: E përshtatur në bazë të OECD (2020).

3.2.1. Burimet vendore publike të financimit

Të ardhurat buxhetore. Burimet vendore publike ose buxhetore janë burimi më i bollshëm i financimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Analizat krahasuese të institucioneve financiare ndërkombëtare tregojnë pa mëdyshje nivelin e ulët të të ardhurave buxhetore si përqindje e PBB-së në Maqedoninë e Veriut dhe rekomandojnë rritje graduale të barrës të përgjithshme fiskale. Rritja arsetohet me nevojën për përmirësimin e cilësisë dhe spektrit së shërbimeve publike, investimet e nevojshme në infrastrukturën fizike dhe kapitalin njerëzor, rritjen e nevojave për servisimin e borxhit dhe të tjera.

Përveç rritjes së normave tatimore, zgjerimit të bazës tatimore dhe futjes së një sistemi progresiv për disa nga tatimet tradicionale, në dy dekadat e ardhshme janë të mundshme edhe tatime të reja si tatimi i karbonit, tatimi për pijet ose produktet me përmbajtje të lartë sheqeri ("tatimii i ëmbël"), tatimi mbi transaksionet financiare, tatimi mbi shërbimet digjitale (të ashtuquajturat tatime digjitale).

Në afat të shkurtër, po shqyrtohen edhe opsionet për një tatim progresiv të përkohshëm mbi fitimin. Ka gjithashtu shumë gjasa që norma proporcionale e tatimit mbi të ardhurat personale të mos mbijetojë në dekadën e ardhshme dhe t'i hapë vendin një sistemi tatimor progresiv.

Politika tatimore, natyrisht, duhet të paraqesë një sërë të lirimeve dhe lehtësimeve tatimore për obliguesit tatimor, veprimtaritë e të cilëve janë në fushat prioritare të zhvillimit të qëndrueshëm. Kredia tatimor (ulja e tatimeve në varësi të sasisë së investimit të qëndrueshëm), amortizimi i përshpejtuar (shlyerja më e shpejtë), përjashtimet nga tatimet indirekte, d.m.th. doganat për inputet e importit, zero përqind tatimi mbi vlerën e shtuar për panelet diellore etj., janë vetëm disa nga lehtësimet dhe lirimet e mundshme tatimore.

Ligji i ri i miratuar për buxhetet (shtator 2022) prezanton për herë të parë rregullat fiskale dhe Këshillin fiskal, avancimin e planifikimit buxhetor afatmesëm, menaxhimin më të mirë të mjeteve shtetërore dhe komunale, monitorimin e rezultateve financiare të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare, të themeluara nga shteti dhe komunat, si dhe vendosja e sistemit të integruar të informacionit për menaxhimin e financave publike (IFMIS).[2] Është jashtëzakonisht e rëndësishme që ky sistem i informacionit të integruar të ketë një modul për buxhetim të veçantë dhe raportim mbi Objektivat dhe synimet e zhvillimit të qëndrueshëm (SDG budget tagging), si dhe një modul të veçantë për financimin dhe raportimin për realizimin e prioriteteve dhe programeve zhvillimore të përcaktuara në Strategjinë nacionale për zhvillim.

Ngarkimi me borxh. Zgjerimi i ofertës (spektrit) të instrumenteve të borxhit do të elaborohet në pjesën e instrumenteve financiare inovative.

3.2.2. Burimet e huaja publike të financimit

Republika e Maqedonisë së Veriut ka përvojë shumëvjeçare me burimet financiare të siguruara nga institucionet financiare ndërkombëtare, si FMN, Banka Botërore, Banka evropiane për rindërtim dhe zhvillim, Banka evropiane për investime, Banka për zhvillim e Këshillit të Evropës, Banka gjermane e investimeve dhe zhvillimit "KfW" dhe kreditorë të tjerë zyrtarë multirateral ose bilateral.

Mbështetja përmes granteve dhe asistencës teknike nga Kombet e Bashkuara (Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara dhe organizata të tjera nën ombrellën e OKB-së), Komisioni Evropian, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe donatorë të tjerë zyrtarë dypalësh (p.sh. qeveritë e Holandës, Britanisë së Madhe, Sllovakisë, RF Gjermanisë, Japonisë, etj.).

Në dekadën e ardhshme, është e dëshirueshme të ripërtrihet bashkëpunimi me Agjencinë për garantimin e investimeve multilaterale (MIGA) dhe Korporatën financiare ndërkombëtare, organizata në kuadër të Grupit të Bankës Botërore.

Gjatë periudhës në të cilën Republika e Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë të jetë kandidate për anëtarësim në BE, ajo do të ketë në dispozicion një pjesë të fondet e para-aderimit nga buxheti i BE-së. Në periudhën deri në vitin 2042, pritet që fondet e para-aderimit të institucionalizohen në kuadër të programeve IPA IV, IPA V etj.

---

[2]Veçanërisht inovacionet e rëndësishme në Ligjin e ri për buxhetet janë rregullat fiskale dhe Këshilli fiskal. Rregullat e reja fiskale parashikojnë një detyrim ligjor që deficiti i qeverisë së përgjithshme të mos kalojë nivelin 3% të PBB-së nominale, borxhi i përgjithshëm i qeverisë së përgjithshme të mos kalojë 60% të PBB-së, ndërsa borxhi publik i garantuar të mos kalojë 15% të PBB-së. Nëse borxhi e kalon nivelin, duhet miratuar një strategji me masa dhe aktivitete për uljen e tij. Prezantimi i rregullave fiskale numerike pritet të sigurojë stabilitet afatgjatë, parashikueshmëri dhe transparencë të financave publike. Devijimet në deficitin buxhetor janë gjithashtu të mundshme, por jo më shumë se 0,5% të PBB-së në nivel vjetor për realizimin e projekteve investuese, ose në rastet kur ka kriza dhe fatkeqësi elementare. Këshillit fiskal do të jetë trupi i ri I pavarur, i cili do të përgjigjet para Kuvendit dhe do të jetë kompetent për: (1) sigurimin e këshillave të pavarura dhe profesionale për çështjet që lidhen me politikën fiskale dhe buxhetin, si dhe (2) sigurimin e analizave dhe mendimeve për strategjinë fiskale, buxhetin republikan, raportin gjysëm vjeçar për realizimin e buxhetit, raportin përfundimtar për realizimin e buxhetit dhe dokumentacion tjetër të parashtruar para Kuvendit. Pritshmëritë nga Këshilli fiskal janë se do të kontribuojë për përforcimin e përgjegjësisë , transparencës dhe llogaridhënies të krijuesve të politikës fiskale.

Anëtarësimi eventual në Bashkimin Evropian do të thotë gjithashtu se Republika e Maqedonisë së Veriut do të jetë një përfituese e mjeteve nga buxheti i BE-së. Mjetet ndërmjet buxhetit të BE-së dhe një shteti anëtar të BE-së lëvizin në dy drejtime – brenda dhe jashtë shtetit anëtar. Nga njëra anë, ka rrjedha të parave nga buxheti i BE-së drejt vendeve anëtare të BE-së. Rrjedhat përbëhen nga mjete që vijnë kryesisht në fushat e bujqësisë, kohezionit dhe konkurrencës (Mrak, 2019). Nga ana tjetër, ka rrjedha të mjeteve nga buxhetet nacionale të vendeve anëtare të BE-së drejt buxhetit të BE-së. Kontributet e shteteve anëtare në financimin e buxhetit të BE-së përbëhen nga tre lloje: (i) resurset personale tradicionale, kryesisht detyrimet doganore, (ii) resurse të bazuara në TVSH dhe (iii) resurset e bazuara në të ardhurat nacionale bruto. Nëse Republika e Maqedonisë e Veriut bëhet anëtare e BE-së në 20 vitet e ardhshme, do të vijnë të ardhura shtesë edhe nga Fondet strukturore dhe kohezive, si një instrument i rëndësishëm financiar i politikës rajonale të BE-së.

3.2.3. Burimet e brendshme vendore

Burimet e brendshme private të financimit përbëhen nga:

- kreditë e bankave komerciale, si një nga burimet më të rëndësishme
- mjetet e investitorëve institucional (p.sh., shoqatat të financimit kapital të sigurimit pensional)
- mjetet e fondeve investuese
- përfitimet e mbajtura të sektorit vendor jofinanciar (korporativ).

Në një sistem financiar të përqendruar në bankë si ai maqedonas, ku mjetet e bankave përfshijnë 79% të mjeteve të sistemit financiar të përgjithshëm, është veçanërisht e rëndësishme përfshirja e bankave si partnerë zhvillimor. Vlen të theksohet se ka edhe çndërmjetësim financiar, respektivisht para të gatshme të konsiderueshme jashtë rrjedhave financiare zyrtare. Pjesëmarrja e lartë e parave të gatshme në qarkullim është një nga indikatorët e ekonomisë joformale (gri). Përdorimi i këtyre mjeteve nuk pasqyrohet në statistikat zyrtare. Prandaj, lufta për çrrënjosjen e ekonomisë gri dhe evazionit tatimor mund të sjellë një shtesë jashtëzakonisht të madhe në burimet publike vendore.

3.2.4. Burimet private ndërkombëtare

Për shkak të kursimeve të kufizuara vendore, Republika e Maqedonisë së Veriut si një ekonomi e vogël dhe e hapur është e orientuar drejt importit të kapitalit. Kapitali i huaj privat hyn në ekonominë maqedonase në formën e investimeve të huaja direkte dhe të huaja të portofolios të huaj, kreditë e huaja nga subjektet private (p.sh. një kredi nga Dojçebank), kreditë tregtare dhe avanset etj. Ndonëse nuk kanë trajtimin kontabël të importeve të kapitalit, por të transaksioneve në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave, remitancat në para janë gjithashtu të ardhura të rëndësishme private ndërkombëtare të mjeteve, të cilat mund të përdoren jo vetëm për konsum, por edhe për investime.

Investimet e huaja direkte (IHD) kanë për qëllim menaxhimin e kapaciteteve të reja të prodhimit (investimet financiare de novo ose investimet në një fushë të gjelbër ("greenfield investment")) ose blerja e një pjese të pakos të aksioneve (zakonisht mbi 10%) me ndikim

vendimtar në kompanitë ekzistuese. Të ardhurat e IHD-ve në ekonominë maqedonase nxitet me përmirësimin e mjedisit afarist, si dhe me ndihmën e bollshme shtetërore (lehtësitë dhe lirimet tatimore, si dhe subvencionet për investitorët e huaj) përmes zonave zhvillimore teknologjiko-industriale. Duke qenë se një politikë e qasjes jo të synuar është zbatuar prej tre dekadash, një nga sfidat e mëdha është të vlerësohet nëse nevojitet një trajtim më i volitshëm për investimet e huaja që synojnë fushat prioritare të zhvillimit të qëndrueshëm.

Grafiku nr. 7. Të ardhurat neto të investimeve të huaja direkte dhe të investimeve të portofolios (si përqindje e PBB-së), 2003-2021

Burimi: Banka popullore (nëntor 2022).

Investimet e huaja të portofolis të sektorit privat janë investime të motivuara kryesisht nga të ardhurat, pa interes të veçantë për menaxhimin e subjektit afarist. Pjesëmarrja e tyre reduktohet në të ardhura në bazë të fletëobligacioneve evropiane në tregun ndërkombëtar të kapitalit, me investime shumë të vogla të fondeve të investimeve të huaja dhe fondeve të kapitalit sipërmarrës (Grafiku nr. 9).

Remitancat në para jashtë vendit apo transferet private janë të ardhura jashtëkonisht të rëndësishme devizore për ekonominë vendore, që orientohet kryesisht drejt konsumit personal. Sipas vlerësimeve të Bankës popullore (2020), të cilat janë bërë sipas një metodologjie ndërkombëtare të harmonizuar me FMN-në, shuma e këtyre remitancave, nga viti 2009 e në vazhdim, kalon një miliard euro në vit, pra është rreth 16% nga PBB-së, mesatarisht.[3]

3.3. Mekanizmat dhe strukturat tradicionale dhe inovative të financimit

Sipas llojit të mekanizmave dhe strukturave të financimit, dallojmë mekanizmat e thjeshtë dhe të kombinuar:

- Mekanizmat dhe strukturat e thjeshta të financimit janë ato në të cilat përdoret një instrument financiar (për shembull, vetëm kredi nga Banka Botërore, me një detyrim të mundshëm për bashkëfinancim nacional)

[3] https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-soopstenie-05082020.nspx.

- Mekanizmat dhe strukturat e kombinuara të financimit janë ato në të cilat bëhet një kombinim i më shumë instrumenteve financiare.

Mekanizmat dhe strukturat inovative të financimit shoqërohen me kombinime të reja të më shumë ose disa instrumenteve financiare nga burime të ndryshme të financimit publik dhe privat (Tabela nr. 2).

Tabela nr. 2. Katër struktura të kombinuara më shpesh të financimit

Strukturat të kombinuara të financimit	Ilustrim
1. Subjektet publike ose organizatat filantropike që sigurojnë mjete nën kushtet e tregut në kuadër të strukturës së kapitalit për të ulur shpenzimet e përgjithshme të kapitalit ose për të siguruar një shtresë të parë të mbrojtjes për investitorët privatë (first-loss capital)	Надреден долг или капитал Прв слој на заштита
2. Subjektet publike ose investitorët filantropikë që përforcojnë mjetet e disponueshme përmes garancive ose emetimeve me çmime nën çmimet e tregut	Гаранции Долг Капитал
3. Grantet e ndihmës teknike që mund të përdoren para ose pas investimit për të përforcuar suksesin tregtar ose ndikimin e zhvillimit	Долг Капитал Грантови за техн. помош
4. Sigurimi i granteve (duke përfshirë përgatitjen ose dizajnimin e projektit) për të tërhequr investitor institucional	Грантови → Долг Капитал

Shtresa e parë e mbrojtjes së kapitalit ose më shpesh shtresa e parë e mbrojtjes së katalizatoritt (Catalytic First Loss Capital, CFLC) është kredi ose letër me vlerë që është në vartësi të kredive apo letrave tjera me vlerë në raport me kërkesat e mjeteve ose të fitimit. Në rast të falimentimit ose likuidimit, kreditorët e borxhit të caktuar nuk do të paguhen derisa borxhi i lartë të paguhet plotësisht. Borxhi i ulët është më i rrezikshëm se borxhi që nuk është i ulët.

3.4. Instrumente inovative të financimit

Instrumentet inovative për financimin e zhvillimit të qëndrueshëm i referohen si sektorit publik ashtu edhe sektorit privat. Ato përfshijnë shumë palë të interesuara: sektorin publik dhe privat, sektorin civil, komunitetin akademik, hulumtues të pavarur dhe inovatorët social, etj.).

3.4.1. Taksat inovative

Tatimi i karbonit është një tatim inovativ, jo tradicional që u impohohet përdoruesve të karburanteve me karbon për të kompensuar ndotjen e mjedisit jetësor. Përmbajtja e karbonit në çdo karburant fosil, nga linjiti deri te nafta për ngrohje dhe gazi natyror, përcaktohet pothuajse saktësisht. Prandaj, tatimi i karbonit do të imponoonte një barrë më të madhe në përdorimin e qymyrit në krahasim me përdorimin e gazit natyror. Tatimi i karbonit është një tatim i drejtëpërdrejtë i vendosur ndaj korporatave të mëdha industriale për emetimet e gazrave serrë me qëllim që t'i inkurajojë ato të lëvizin drejt prodhimit më të pastër dhe më efikas. Tatimi i karbonit në Evropë zbatohet nga Suedia, Danimarka, Mbretëria e Bashkuar dhe vetë BE-ja. "Tatimi

i karbonit" i Bashkimit Evropian është në thelb Sistemi i tregtimit të emetimeve të BE-së. Hyrja në BE nënkupton edhe pjesëmarrjen në sistemin BE-së për tregtimin e emetimeve të BE-së.

Tatimi për pijet e ëmbla dhe produktet me përmbajtje të lartë të sheqerit (i ashtuquajturi "Tatimi i ëmbël"). Belgjika, Finlanda, Franca, Hungaria, Irlanda, Letonia, Monako, Norvegjia dhe Portugalia janë ndër anëtarët e parë të BE-së që kanë vendosur tashmë një tatim për pijet me sheqer. Ideja është të destimulohet konsumimi i pijeve, konsumimi i vazhdueshëm i të cilave pothuajse në mënyrë të pashmangshme çon në diabet dhe obezitet (trashësi e tepruar)

Tatimi mbi transaksionet financiare. Ky takim rekomandohet për lloje të caktuara të transaksioneve, si blerja e aksioneve dhe fletëobligacioneve. Tatimi i transaksioneve financiare zbatohet në Spanjë, Francë, Britani të Madhe, Belgjikë, Zvicër, Poloni, Finlandë dhe Itali. Kështu, për shembull, Italia taton me një tatim për transaksionet financiare prej 0,1% dhe 0,2%, investimet financiare në aksione dhe pjesë dhe blerjen e derivateve financiare. Mbretëria e Spanjës vendos një taksë me 0,2% të transaksioneve financiare për blerjen e aksioneve në kompani, kapitalizimi i tregut i të cilave kalon 1 miliard euro.

Tatimi mbi shërbimet digjitale (tatimi digjital). Sipas sistemit aktual të tatimit të shërbimeve digjitale, kompanitë shumënacionale paguajnë tatimin mbi fitimin në vendin e prodhimit, por jo aty ku ndodhen konsumatorët e shërbimeve digjitale. Parimi i tatimit të shërbimeve digjitale sipas lokacionit të konsumatorëve është inkorporuar në shtyllën e parë (Pillar One) me iniciativë të Organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD), e cila është e koordinuar në 130 shtete. Deri në fund të vitit 2023, pritet edhe një zgjidhje e re për tatimin e shërbimeve digjitale (p.sh. përdorimi i shërbimeve të Netflix) sipas lokacionit të konsumatorëve.

Edhe pse nuk është një tatim klasik, por të ardhura që nuk i nënshtrohen tatimit, do ta përmendim edhe në këtë kategori *kompensimin për komunikacionin shumë të dendur në qendër të qytetit* (city congestion charge). Hyrja e automjeteve në pjesën qëndrore të Londrës i nënshtrohet një kompensimi ditor prej 15 funta britanike nga e hëna në të premte, nga 7 e mëngjesit deri në ora 18 dhe nga ora 12 deri në 18 gjatë fundjavave dhe festave. Nëse automjeti nuk i plotëson standardet e shkarkimeve ultra të ulëta, paguhet një kompensim shtesë. Në këtë mënyrë parandalohet bllokimi i komunikacionit dhe ndotja e ajrit ambiental në zonën qëndrore të qytetit.

Grafiku nr. 8. Vendet që kanë prezantuar tatimin e karbonit në botë dhe tatimin e shërbimeve digjitale në Evropë





3.4.2. Mbështetje inovative e sipërmarrjes

Shumë vende evropiane praktikojnë mbështetjen shtetërore për të ashtuquajturat sipërmarrje të qëndrueshme (sustainable entrepreneurship). Në këtë mënyrë, bëhet dallimi ndërmjet sipërmarrjes së përgjegjshme ekologjike ("Ecopreneurship") dhe sipërmarrjes sociale ("Social entrepreneurship").[4] Kompani e re e themeluar ose "startap" përkufizohet si një sipërmarrje afariste, e cila ka: (1) të paktën një anëtar të ekipit i cili është i përkushtuar me kohë të plotë për zhvillimin e startapit; (2) produkt/shërbim premtues me potencial të rritjes eksponenciale dhe ambicie për t'u zhvilluar në tregun global; (3) të ardhura prej të paktën 10 mijë dollar amerikan dhe/ose 10 mijë dollar amerikan të fituara nga burimet e jashtme të financimit (Startup Genome, 2020).

Një nga dështimet e tregut që lidhet me zhvillimin e sipërmarrjes së qëndrueshme është qasja e kufizuar në financim. Sektori bankar tregohet i kujdesshëm në financimin e startapeve, për shkak të përshtypjes se bëhet fjalë për projekte shumë të rrezikshme apo aplikime për kredi me analiza të përgatitura në mëyrë jo-adekuate. Pengesa të tjera për zhvillimin e sipërmarrjes janë mungesa e njohurive dhe kulturës startap. Shumë prej këtyre startapeve nuk kanë fonde të mjaftueshme, megjithëse kanë potencialin të zgjerohen në sipërmarrje afariste jashtë subjektit afarist ("spinoffs") ose të rriten në kompani dinamike me rritje të shpejtë të shitjeve ("scaleups"). Pikërisht mekanizmat dhe instrumentet inovative të mbështetjes shihen si një mënyrë e plotësimit të mbështetjes me instrumente tradicionale.

Për të siguruar mbrojtje kundër humbjes së fuqisë blerëse, veçanërisht gjatë periudhave të rritjes së normës së inflacionit, disa qeveri emetojnë gjithashtu fletëobligacione të indeksuara për inflacionin.

Fletëobligacionet e indeksuara për PBB

Fletëobligacionet e lidhura me PBB-në ose fletëobligacionet e indeksuara me rritjen ekonomike (Growth-Indexed Bonds, GIB) lidhin shlyerjet e fletëobligacioneve shtetërore me normën e rritjes ekonomike të vendit emetues. Ato janë të fokusuara në dimensionin ekonomik të financimit të qëndrueshëm dhe synojnë të reduktojnë prociklikitetin e politikës fiskale dhe mundësinë për paraqitjen e krizave të borxhit (Chamon dhe Mauro, 2006).

3.4.10. Financa inovative lokale

Arkëtimi më i mirë e të ardhurave personale është një instrument financiar tradicional, i cili ka një potencial shumë të madh të papërdorur në nivel lokal. Qasjet inovative në këtë pjesë konsistojnë në përditësimin e bazave të të dhënave për përfshirjen dhe vlerën reale (të tregut) të pronës të patundshme në territorin e komunave, një pasqyrë më realiste të marrëveshjes tatimore për tatimin mbi pronën e fletëobligacioneve etj.

Ka edhe qasje inovative në diazajnimin e transfereve nga buxheti qendror drejtë NJQV-ve, nëpërmjet udhëzimit të tyre në: (1) barazimin e përforcuartë pabarazive fiskale lokale (enhanced equilization); (2) përmes komponentës së tyre motivuese (grantet për sukses) në bazë të arkëtimit të përmirësuar të të ardhurave personale ose (3) rritjes së fuqisë diskrecionale në shpenzimin e mjeteve (shpërndarja e lirë e shpenzimeve në kuadër të bllok dotacionit për një kompetencë të caktuar).

Ekzistojnë gjithashtu disa mjete inovative për të forcuar financat lokale përmes ngarkimit me borxh për qëllime të përgjithshme, për të financuar projekte konkrete ose për të reduktuar detyrimet komunale dhe detyrimet e ndërmarrjeve publike lokale.

Fletëobligacioni komunal

Fletëobligacioni komunal është një nga modalitetet për ngarkimin me borxh afatgjatë të komunave. Shuma e tij duhet të jetë në përputhje me kufijtë e ngarkimit me borxh. Procedura e lëshimit është e rregulluar dhe varet nga pëlqimi paraprak i Ministrisë së financave dhe Komisionit të letrave me vlerë. Të ardhurat nga fletëobligacionet komunale mund të përdoren për dedikime të përgjithshme ose për shpenzime kapitale konkrete (investimet lokale).

Fletëobligacion komunal pa interes

Fletëobligacioni komunal pa interes është një instrument financiar, i cili sipas Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për financimin e NJQV-ve (173/2022, datë 1.08.2022) mund të lëshohet nga komuna për një blerës të njohur - Ministria e financave. Afati i maturimit është maksimumi dhjetë vjet, ku komuna ka detyrimin të paguajë çdo vit këste të barabarta vjetore në llogarinë e Ministrisë së financave. Fletëbligacioni komunal pa interes lëshohet sipas një prospekti të përgatitur më parë dhe një akti për miratimin e emetimit të letrave me vlerë nga Komisioni i letrave me vlerë.

Fletëobligacioni strukturor komunal

Fletëobligacioni strukturor komunal është një instrument, i cili përfshin emetimin e një obligacioni strukturor nga ana e Ministrisë së financave me kërkesë të komunës. Afati i maturimit është maksimumi dhjetë vjet, ku komuna ka detyrimin të paguajë çdo vit këste të barabarta vjetore në llogarinë e Ministrisë së financave.

3.4.11.Partneritete inovative publike private

Partneritetet publike private (PPP) kanë potencialin për të përshpejtuar tranzicionin drejtë një ekonomie të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Edhe pse është e qartë përshtypja se ende nuk kanë ardhur në jetë PPP-të tradicionale në praktikën maqedonase dhe se potenciali i tyre mbetet pothuajse i pashfrytëzuar, ne do t'i referohemi shkurtimisht modeleve inovative të PPP-ve. PPP-të kanë një potencial tepër të fuqishëm, i cili mund të shfrytëzohet në një mjedis të qeverisjes së mirë dhe kapaciteteve të kënaqshme institucionale. Kjo është veçanërisht e vërtetë për investimet e mëdha, për shembull, në fushën e energjisë ose shëndetësisë, ku mobilizimi i kapitalit privat mund të përshpejtojë procesin e modernizimit ose mbindërtimi të infrastrukturës. Kundërshtarët e PPP zakonisht theksojnë shpeshtësinë e praktikave korruptive, kapacitetin e

kufizuar administrativ për të vlerësuar interesin financiar të shtetit, kapacitetin e kufizuar për të ndjekur gjenerimin e të ardhurave, etj.

Paneli nr. 2. Rreziqet që lidhen me partneritetin publik-privat

Në raportin e saj tematik nga auditimi i PPP-ve në të gjithë Bashkimin Evropian, Gjykata Evropiane e revizorëve doli me një studim që tregon rreziqet që lidhen me këtë lloj të financimit. Disa nga gjetjet janë rradhitur në vazhdim: "PPP-të rrisin rrezikun e konkurrencës së pamjaftueshme dhe kështu i vendosin institucionet kontraktuese në një pozitë më të dobët negociuese. Shumica e PPP-ve që ishin lëndë e revizionit tregojnë joefikasitet të konsiderueshëm në formë të vonesave gjatë ndërtimit dhe tejkalimeve të mëdha të shpenzimeve. Analizat e PPP bazohen në skenarë tepër optimist në lidhje me kërkesën e ardhshme dhe përdorimin e infrastrukturës së planifikuar, duke rezultuar në norma të shfrytëzimit të projektit deri në 69% (për TIK) dhe 35% (për autostrada) nën shumat e parashikuara" (Gjykata Evropiane e revizorëve, 2018).

PPP-të tradicionale (PPPt) mundësojnë që një palë kontraktuese private të sigurojë një mall ose shërbim (me shpesh infrastrukturë publike) në bazë të një kontrate afatgjate me sektorin publik.

PPP-të inovative (PPPi) përfshijnë sektorin publik, sektorin privat, shoqërinë civile, komunat, universitetet, qendrat hulumtuese, institucionet multilaterale, sipërmarrësit socialë dhe inovatorët.

Në lidhje me dizajnimin e sistemit të shpërblimit për pjesëmarrësit nga sektori privat, ndahen dy grupe të gjera të PPP-ve:

- PPP që bazohet në tarifat e përdoruesve (user-fee PPPs) i japin një pale kontraktuese private të drejtën për të dizajnuar, ndërtuar (ose ripërtrirë ose zgjeruar), mirëmbajtur, operuar dhe financuar mjetet e infrastrukturës në pronësi të sektorit publik
- PPP e bazuar në disponueshmërinë e shërbimit (Availability-based PPPs) - Institucioni nga sektori publik – por jo përdoruesit përfundimtar – realizon pagesa për palën private. Këto pagesa zakonisht bëhen kur shërbimi bëhet i disponueshëm

Projekte të shumta për PPP mund të lehtësohen dhe/ose të mbështeten nga institucionet financiare ndërkombëtare, sigurimi i granteve dhe asistencës teknike (Banka ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim), sigurimi nga rreziku politik (Agjencia multilaterale për garantimin e investimeve), mobilizimi i kreditorëve që ofrojnë mbështetje për sektorin privat (Korporata financiare ndërkombëtare) dhe/ose përshpejtimi i tranzicionit të gjelbër (Banka evropiane për rindërtim dhe zhvillim), etj. Departamenti për PPP në Maqedoninë e Veriut ndodhet në Sektorin për çështje juridike në Ministrinë e Ekonomisë dhe është i rregulluar me Ligjin për koncesione dhe partneritet publik privat. Në të njëjtën kohë, duhet të theksohet se propozimi i ri dhe bashkëkohor i Ligjit për partneritet publik privat prej 19 muajsh "pritet" në labirintin e procedurave parlamentare. Ai siguron transponimin e Direktivës 2014/23/BE për dhënien e kontratave për koncesion dhe bën harmonizimin e mëtutjeshëm me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e PPP-ve.

Paneli nr. 3. Partneritetet inovative publike private

Universitet për të gjithë" (ProUni)
1,8 milionë bursa të plota ose të pjesshme për studentët nga familjet me të ardhura të ulëta për të hyrë në arsimin universitar
Pjesëmarrës: Ministria e Arsimit, Organizatat joqeveritare dhe filantropike, Caixa Economica Federal, Federata e bankave braziliane, Brazil (2005-2013)
Lirimet tatimore për 1304 kompani të sektorit privat pjesëmarrës në këtë iniciativë

Ndriçim më i mirë dhe më ekonomik i rrugëve dhe sigurisë publike në qytete (2019)
PPP në nivel komunal për ndriçim rrugor më të mirë dhe më ekonomik (rritje e efikasitetit energjetik me 70%) (Bhubanesvar, Xhaipur, Bengalaru në Indi)

Ulja e pabarazisë gjinore në Kosta Rika, El Salvador, Peru dhe Panama

Instituti i Kornell për administratën publike në bashkëpunim me Presidentin e Panamasë
Trajnime për administratën publike dhe studentë në fushën e PPP, infrastrukturës, shkencës, teknologjisë, zhvillimit të qëndrueshëm, drejtësisë sociale

Ndërtimi i një kompleksi spitalor
Ndërtimi i një kompleksi spitalor ("Kompleksi Shëndetësor Adana") dhe dy spitale të tjera të mëdha në Elik dhe Kajseri përmes Programit shëndetësor turk të financuar nga PPP. Qëllimi është modernizimi i sistemit turk të kujdesit shëndetësor dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve. IBRD ka siguruar ndihmë teknike për të ndihmuar në menaxhimin e kontratave për PPP. MIGA siguroi sigurimin e rrezikut politik për 6 projekte me vlerë 848 milionë dollarë amerikan. IFC investoi 163 milionë dollarë amerikan në borxh dhe ndihmoi në mobilizimin e 430 milionë dollarëve amerikan shtesë nga huadhënësit nga sektori privat. BERZH bashkëpunoi me MIGA për të ofruar përmirësime kreditore për një fletëobligacion të gjelbër prej 288 milionë euro për të ndërtuar një spital modern me 1550 shtretër spitalor.

"72 orët e ardhshme" (Nepal, 2015)
Një program i financuar me PPP për reagim të shpejtë dhe efikas për të ndihmuar qytetarët e prekur nga katastrofat natyrore në afat prej 72 orëve

Ndërtesa e re e shkollës së mesme "Fran Galoviq" dhe sallës sportive në Koprivnica (Kroaci)
Kontratë 25-vjeçare për kompensim të detyrueshëm mujor nga ana e komunës.

Restaurimi i Pallatit të qarkut Varazhdin (sektori i kulturës, Kroaci)
Kontratë 20-vjeçare për pagesën e kompensimit mujor.

Projekti Taishin në El Salvador (Japonisht: Taishin, rezistent ndaj tërmetit)
Një projekt i përbashkët nga Meksika, Japonia dhe dy universitete nga El Salvador për të ndihmuar qytetarët e El Salvadorit me "përforcimin e teknologjisë për të ndërtuar struktura banimi popullore rezistente ndaj tërmeteve". Shtëpi me tulla të armuara të pjekura në temperaturë të ulët, me energji diellore. Kjo metodë është ekologjike dhe kërkon punë intensive dhe ka përparësinë e disponueshmërisë lokale të materialeve themelore të ndërtimit.

Një shtesë e rëndësishme në burimet publike vendore mund të sjellë edhe matjen aktuale të lartësisë të kompensimeve për koncesion të burimeve të caktuara natyrore. Aktualisht, burimet natyrore shfrytëzohen pa mëshirë me një kontribut fiskal jashtëzakonisht modest në të ardhurat publike. Ai imponon nevojën për një revizion të plotë dhe të pavarur të kontratave ekzistuese dhe një qasje inovative (duke angazhuar ekspert dhe konsulentë të pavarur të partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit) gjatë matjes të kushteve të eksploatimit dhe kompensimit për koncesion për të mirat e interesit të përgjithshëm.

4. ANALIZA KRAHASUESE E PËRVOJAVE TË FINANCIMIT TË STRATEGJIVE NACIONALE ZHVILLIMORE NË EVROPËN JUGLINDORE

Përshtypja e përgjithshme e analizës të disa strategjive nacionale zhvillimore është se pjesa për financimin e tyre është mjaftë e përgjithshme, me një numërim tatimor të burimeve të mundshme të financimit të brendshëm dhe të jashtëm, publik dhe privat. Çështjet financiare janë lënë për operacionalizimin në strategjitë fiskale afatmesme.

Republika e Kroacisë

Strategjia nacionale për zhvillim 2030 e Republikës së Kroacisë është një plan nacional strategjik për veprim për periudhën 2018-2030, i cili synon të mbështesë tranzicionin e dyfishtë digjital dhe të gjelbër të shoqërisë dhe ekonomisë kroate. Strategjia nuk është shumë eksplicite dhe konkrete për sa i përket financimit. Ajo thekson se disponueshmëria e burimeve financiare dhe rradhitja e zbatimit të ndërhyrjeve strategjike do të përcaktohen nga programet katërvjeçare për zbatim në nivel nacional, rajonal dhe lokal, si dhe do të varen nga pasojat e krizës aktuale në dinamikën e të ardhurat buxhetore.

Instrumentet inovative	Përshkrim i shkurtër
Fondi për kapitalin sipërmarrës (të rrezikshëm)	Në korrik të vitit 2015, Banka botërore miratoi një hua në vlerë prej 20 milionë euro për themelimin e Projektit të kapitalit të rrezikshëm për inovacion dhe sipërmarrësi. Ky projekt synon të përforcojë financimin me kapital të rrezikshëm për ndërmarrjet inovative të vogla dhe të mesme (NVM) dhe ndërmarrjet e reja në Kroaci dhe t'i ndihmojë sektorit privat të bëhet më i fortë, më produktiv dhe më konkurrues.
Ndihmë teknike për hulumtim dhe inovacion	Në shtator të vitit 2021, u nënshkrua një kontratë këshillëdhënëse sipas së cilës Banka botërore do të ofrojë ndihmë teknike për të mbështetur Qeverinë e Kroacisë në përmirësimin e efektivitetit dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e politikave të hulumtimit dhe inovacionit. Projekti këshillëdhënës siguron ndihmë teknike afatgjate dhe të kontribute për hartimin, zbatimin dhe ndjekjen dhe vlerësimin (M&E) të politikës për hulumtim dhe zhvillim dhe inovacionit (RDI) gjatë periudhës programuese të BE-së 2021-2027.
Fletëobligacioni i gjelbër korporativ (Qasja e performancave)	Në gusht të vitit 2022, M+ Group u bë kompania e parë në Kroaci që lëshoi fletëobligacione të lidhura me qëndrueshmërinë me vlerë prej pothuajse 40 milionë euro. Është një ofrues i shërbimeve për proceset afariste dhe autsors teknologjik me seli në Zagreb me operacione në 58 vende. Partnerët strategjik në emetimin e fletëobligacioneve të gjelbërta janë Erste & Steiermärkische Bank dhe Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim (BERZH). Nëse objektivat për qëndrueshmëri nuk përmbushen, investitorët do të paguhen 0,75 pikë përqind mbi normën nominale të interesit prej 4,25%.

Republika e Serbisë

Serbia ka dokumente të shumta tematike strategjike që përbëjnë universin e Strategjisë themelore nacionale për zhvillim:

Instrumentet inovative	Përshkrim i shkurtër
Fletëobligacioni i gjelbërt shtetëror	Në shtator të vitit 2021, Serbia lëshoi një fletëobligacion të gjelbërt prej 1 miliard euro për të financuar agjendën e gjelbërt të vendit. Të ardhurat mund të përdoren vetëm për financimin dhe rifinancimin në fushat e energjisë së ripërtërishme (me emetime deri në 100 gram CO2 ekuivalent për kilovat/orë), efikasitet energjetik, menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe ujërave të zeza, parandalimit dhe kontrollit të ndotjes dhe ekonomisë qarkulluese, mbrojtjes të mjedisit jetësor dhe biodiversitetit dhe bujqësisë të qëndrueshme.
Ndërtimi i një super-kllasteri	"Serbia inovon" është një aktivitet prej 6 milion dollarëve amerikan (i mbështetur nga USAID) për të përshpejtuar zhvillimin, futjen e modeleve të reja ekonomike që do të përforcojnë ekonominë e Serbisë të udhëhequr nga inovacionet, do të përforcojnë zhvillimin e qëndrueshëm, konkurrencën dhe potencialin e eksportit. Qëllimi kryesor i projektit është zhvillimi i një superkllasteri, një model biznesi që inkurajon bashkëpunimin intensiv midis ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe ndërmarrjeve të formuara të reja, investitorëve, universiteteve dhe institucioneve relevante shtetërore.

Republika e Malit të Zi

Në korrik të vitit 2016, Republika e Malit të Zi miratoi Strategjinë e re për zhvillim deri në vitin 2030 dhe Planin 15-vjeçar për veprim. Bartëse e procesit është Ministria për zhvillim të qëndrueshëm dhe turizëm. Një nga risitë e paralajmëruara në SNZH është formimi i një eko-fondi të ri , në të cilin do të derdheshin të gjitha detyrimet publike dhe kreditë të dedikuara për projektet e mbrojtjes të mjedisit jetësor. Për momentin nuk ka fonde për kapital sipërmarrës (të rrezikshëm), dhe disa startape kanë aplikuar për financim në "South Central Ventures Fund" në Beograd (Serbi).

Instrumentet inovative	Përshkrim i shkurtër
Investime të përbashkëta në fushat prioritare	UGT Renewables (UGTR) me seli në Majami ka nënshkruar një kontratë me kompaninë shtetërore malazeze të energjisë elektrike "Elektroprivreda Crne Gore"(EPCG). Kontrata është për zhvillimin e përbashkët të projekteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme si dhe për ruajtjen e energjisë. Kompania do të zgjerojë programet e saj solare në kulm 3000+ në 5000+ solar në çati, duke synuar të instalojë 70 MW të kapacitetit të përgjithshëm. Hyundai Engineering shpreson të ofrojë zgjidhje të energjisë së gjelbërt në Mal të Zi dhe Ballkan së bashku me UGT Renewables.

Fondi për financimin e ekonomisë së gjelbërt	Në mars të vitit 2021, në Mal të Zi u lançua një fond i ri për financimin e ekonomisë së gjelbërt dhe mbështetjen e investimeve të gjelbërta.

5. HAPAT E ARDHSHME

Financimi i prioriteteve zhvillimore. Suksesi i Strategjisë nacionale për zhvillim (*që duhet të financohet)* varet nga kapaciteti i qeverive të ardhshme për të siguruar burime të mjaftueshme të financimit në masë të mjatueshme (*si do të financohet dhe zbatohet)*. Në këtë kontekst, vetëm ajo strategji nacionale për zhvillim, për realizimin e së cilës janë ndarë mjete të mjaftueshme buxhetore dhe është mobilizuar kapital shtesë privat nga burime vendore dhe të huaja, mund të mundësojë prosperitet gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe të rrisë cilësinë e jetës së qytetarëve.

Qasje e integruar. Nevoja për qasje të integruar vërtetohet gjithashtu përmes Agjendës për veprim nga Addis Abeba (2015), e cila propozon futjen e kornizës të integruar të financimit nacional si mbështetje të strategjisë nacionale për zhvillim (OKB, 2019). Korniza e integruar për financim siguron mundësi për sinergji dhe për të analizuar kompromiset e nevojshme (trade-off) të politikave të caktuara. Operacionalizimi i Kornizës së integruar për financim përbëhet nga katër blloqe të ndërtimit: (1) vlerësimi dhe diagnostikimi; (2) dizajnimi i një strategjie financiare; (3) mekanizmat për monitorim, rishikim dhe llogaridhënie; (4) mekanizmat për qeverisje dhe koordinim.

Strategjia nacionale për financim. Me gjithë rrezikun e prodhimit të tepërt të strategjive, rekomandohet hartimi i një Strategjie nacionale për financimin e prioriteteve zhvillimore, e cila mund të jetë pjesë përbërëse ose aneks i SNZH. E njëjta do të konkretizohej dhe operacionalizohej në dokumentin ekzistues afatmesëm – Strategjia fiskale për pesë vitet e ardhshme.

Financimi inovativ kryesisht si një plotësues i financimit tradicional. Mekanizmat dhe instrumentet inovative të financimit në asnjë mënyrë nuk përjashtojnë burimet dhe instrumentet tradicionale të financimit. Kështu, për shembull, instrumentet financiare inovative nuk mund të zëvendësojnë kapacitetin e pamjaftueshëm për të aplikuar dhe marrë grante nga Bashkimi Evropian, të disponueshme përmes Instrumentit për asistencën e para-aderimit (IPA), Instrumentit për asistencën e para-aderimit dhe zhvillimin rural (IPARD), programet për konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME), Evropa Kreative, Erasmus+, Horizont 2020 (Horizon 2020) dhe shumë të tjera. Nga ana tjetër, instrumentet inovative në disa raste mund të jenë zëvendësim për instrumentet tradicionale. Për shembull, financimi nëpërmjet një fletëobligacioni të gjelbërt të qeverisë redukton pjesërisht nevojën për financim përmes fletëobligacionit tradicional për dedikim të përgjithshëm.

Tabela nr. 6. Dinamika e dëshiruar e futjes dhe praktika e përdorimit të tatimeve dhe fletëobligacioneve inovative



Pronësi më e madhe vendore mbi financimin inovativ. Pronësia vendore mbi burimet inovative të financimit të zhvillimit është e një rëndësie shumë të madhe për të siguruar rezultate afatgjate të zhvillimit. Ashtu si me reformat tjera, mbështetja e plotë tek partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit me përfshirje pasive vendore nuk do të sigurojë vazhdimësi në përpjekjet për të futur mekanizma dhe instrumente inovative për financimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Parakushtet institucionale. Nevojitet një strukturë e fuqishme institucionale, e cila do të ketë mandat për të koordinuar dhe mbështetur procesin, për të monitoruar dhe vlerësuar aktivitetet e realizuara dhe për të zbatuar masa korrigjuese. Ai sektor ose njësi preferohet të jetë vendosur ose në Zyrën e kryetarit të qeverisë ose në Ministrinë e Financave në mënyrë që të ketë pushtet legjitim ose hierarkik. Gjithashtu, duhet të përforcohen vazhdimisht kapacitetet institucionale (administrative) për prezantimin dhe monitorimin e mekanizmave dhe instrumenteve inovative të financimit. Një nga parakushtet për këtë është demokratizimi i shkallës së rrogave të sektorit publik, respektivisht pozitat të cilat kërkojnë më shumë ekspertizë dhe përgjegjësi të paguhen më shumë. Në këtë mënyrë, kapitali njerëzor cilësor do të mbahet në pozitat vendimmarrëse në sektorin publik.

Një dokument "i gjallë" ose i përditësuar rregullisht. Në interes të efektivitetit, koherencës dhe pajtueshmërisë më të madhe, rekomandohet përditësimi i rregullt i Strategjisë nacionale për zhvillim. Epoka moderne karakterizohet nga një pasiguri e madhe, e cila lehtë mund ta largojë ekonominë nga rruga e saj e zhvillimit. Në këtë mënyrë, në të ardhmen e afërt do të përcaktohen më saktë burimet e nevojshme të financimit.

Funksionalizimi i Strategjisë nacionale për zhvillim. SNZH duhet të specifikohet në planet e mëvonshme afatmesme me burime të përcaktuara në mënyrë indikative të financimit të prioriteteve të zhvillimit (Medium-Term Expenditure Framework).

Shfrytëzimi i komplementariteteve. Kudo që është e mundur, është e dëshirueshme që një projekt i investimit të ndikojë në disa Objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm. Financimi i banesave (ndërtesave) me efikasitet energjetik për strehimin e kategorive me rrezik social, për shembull, ndikon në mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe sferës sociale.

Përmirësimi i koordinimit ndërmjet palëve të interesuara. Duhet të futen mekanizma dhe instrumente të rinj financiar në koordinim me partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit dhe sektorin privat. Ndryshe nga partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit të cilët janë plotësisht të përkushtuar në zhvillimin e qëndrueshëm, më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet përfshirjes së sektorit privat në financimin e Objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (SDG financing) Në ekonomitë e zhvilluara evropiane, tashmë janë krijuar praktika për raportimin (llogaridhënien) e sektorit privat në lidhje me aktivitetet që synojnë përmbushjen e Objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Qasje me etapa. Disa instrumente mund të prezantohen vazhdimisht gjatë dy dekadave të ardhshme, ndërsa të tjerët kërkojnë më shumë kohë dhe përvojë. Për shembull, fletëobligacionet inovative duhet të futen gradualisht. Fillimisht, sipas qasjes "përdorimi i të ardhurave" ose qëllimit të shpallur publikisht të të ardhurave nga fletëobligacionet, kurse më vonë, mund të shkoni edhe sipas "qasjes së performancës". Sa për ilustrim, një fletëobligacion i gjelbërt qeveritar mund të emetohet në vitin 2023 me një përdorim të përcaktuar qartë të të ardhurave për financimin e projekteve ekologjike. Në vitin 2030, një fletëobligacion i gjelbërt mund të emetohet me synime të performancës (për shembull, një reduktim prej 20% në emetimet e gazrave serrë në fund të vitit 2035 krahasuar me nivelin në fund të vitit 2030.

Tejkalimi i hendikapit të një ekonomie të vogël. Shumë fonde të kapitalit sipërmarrës dhe shumë investitorë të huaj (direkte ose portofolio) nuk janë të interesuar për një ekonomi të vogël. Ekonomitë e vogla dhe të hapura janë të ndjeshme ndaj goditjeve të jashtme dhe luhatjeve të aktivitetit ekonomik. Për këto arsye, zgjidhja është në integrimin në kontekstin rajonal dhe evropian. Nëse fondet kanë mundësi të veprojnë në kornizat rajonale (Ballkani Perëndimor), kurse investitorët vazhdojnë të gëzojnë përfitimet e tregut evropian, më shumë kapital i huaj mund të tërhiqet si plotësim i kursimeve të brendshme.

Përmirësimi i kapitalit njerëzor. Pothuajse identike me kapacitetin administrativ të sektorit publik, kapitali i huaj kërkon një fuqi punëtore të kualifikuar me arsim dhe aftësi bashkëkohore. Tërheqja e kapitalit të huaj ekskluzivisht për shkak të fuqisë së lirë të punës është një strategji afatshkurtër që po humbet fuqinë me emigracionin e përshpejtuar, plakjen e popullsisë dhe uljen e papunësisë. Suksesi i Strategjisë nacionale për zhvillim, si dhe i mekanizmave dhe instrumenteve inovatore për financimin e saj, do të varet nga investimi në kapitalin njerëzor. Modernizimi i përmbajtjeve mësimore, forcimi i sistemit të akreditimit dhe vlerësimit të programeve të arsimit të lartë, promovimi i arsimit dual, futja e standardeve më të larta në fushën e publikimeve shkencore dhe veprimtarisë të inovacionit do të kenë ndikim të volitshëm.

Qeverisje e mirë. Në nivel nacional, sundimi i ligjit, përmirësimi i cilësisë dhe zbatimit të rregullativës (në hap me legjislacionin mbinacional evropian), ulja e nivelit të korrupsionit, përforcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative dhe braktisja e kulturës së mosndëshkimit janë gjithashtu përbërës të rëndësishëm për futjen e suksesshme të mekanizmave dhe instrumenteve inovative dhe përdorimi më i mirë i atyre tradicionale. Në nivelin korporativ, qeverisja e mirë korporative, etika dhe përgjegjësia sociale korporative, transparenca, morali tatimor dhe praktikat antikorrupsion janë faktorë jo më pak të rëndësishëm për futjen e suksesshme të mjeteve inovative dhe financimin e suksesshëm të zhvillimit të qëndrueshëm.

Politika e inovacionit dhe sistemi i inovacionit. Politika e dikurshme industriale po shkon ngadalë në histori, duke lënë gjithnjë e më shumë hapësirë për politikën e inovacionit. Inovacioni ka potencialin për të rritur produktivitetin, i cili “mund të mos jetë gjithçka, por në planin afatgjatë është *pothuajse* gjithçka" që nevojitet për avancim gjithëpërfshirës dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Çdo inovacion, duke përfshirë atë të futur nga startapet, ka potencialin të shkaktojë ndryshime tektonike në sferën socio-ekonomike. Mekanizmat dhe instrumentet inovative do të arrijnë efektin më të fuqishëm dhe sinergjinë më të madhe, nëse ato janë plotësuese dhe mbështesin sistemin e inovacionit. Ekonomia është më shumë në fazën e përshtatjes teknologjike sesa krijimit dhe inovacionit (Freudenberg, 2020). Prandaj, nevojitet: (1) përmirësimi i absorbimit teknologjik nga ana e kompanive; (2) përforcimi i efekteve të përhapjes (spillover effects) nga kompanitë shumënacionale drejtë furnizuesve dhe shpërndarësve vendor; (3) modernizimi i teknologjive ekzistuese të prodhimit dhe futja e teknologjive inovative në sektorët tradicionalë.

Aneksi nr. 1. Institucionet financiare ndërkombëtare dhe nacionale që janë aktive në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Institucioni	Përshkrim i shkurtër
Kombet e Bashkuara (KB)	Zyra e koordinatorit të përhershëm të KB përfshin të gjitha organizatat në sistemin e KB të përfshira në aktivitetet e zhvillimit operacional, pavarësisht nga prania e tyre formale. Duke punuar ngushtë me qeverinë nacionale, koordinatori rezident dhe ekipi i vendit angazhohen për interesat dhe mandatet e sistemit të KB. Koordinimi i operacioneve të zhvillimit promovon mbështetje më të madhe strategjike për planet dhe prioritetet nacionale të shtetit, rrit efikasitetin e operacioneve dhe redukton shpenzimet transaksionale për qeveritë.
Grupi i Bankës botërore	Grupi i Bankës botërore (WBG) ofron mbështetje për vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion nëpërmjet kredive të volitshme, këshillave për politikat, hulumtimeve dhe analizave dhe ndihmës teknike. Portofolioja e tij përfshin programet për zhvillimin e sektorit, si dhe përgatitjen dhe zbatimin e projekteve.
Banka evropiane e investimeve (EIB) dhe fondet shoqëruese	Banka evropiane e investimeve (BEI) Banka është huadhënësi kryesor në emër të Bashkimit Evropian dhe institucioni më i madh financiar multilateral në botë. Është një nga ofruesit më të mëdhenj të financave të klimës. EIB është e përkushtuar të ndihmojë zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës, promovimin e barazisë dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve të BE-së dhe qytetarëve të vendeve në tranzicion dhe vendeve në zhvillim.
	Fondi evropian i investimeve (FEI) Fondi evropian i investimeve është pjesë e grupit të BEI. Është një ofrues i specializuar i financimeve më pak të rrezikshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në të gjithë Evropën. FEI harton dhe zhvillon kapitalin e rrezikshëm dhe kapitalin për rritje, garancitë dhe instrumentet mikrofinanciare që synojnë në mënyrë konkrete këtë segment të tregut. Në këtë rol, FEI nxit objektivat e BE-së për të mbështetur inovacionin, hulumtimin dhe zhvillimin, sipërmarrjen, rritjen dhe punësimin.
	Instrumenti për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe inovacionin në Ballkanin Perëndimor (WB EDIF) Fondi evropian i investimeve (FEI) dhe tre filialat e grupit ProKredit kanë nënshkruar kontratë garancie për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në Serbi, Kosovë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo u mundësua përmes Mekanizmit të garancisë për Ballkanin Perëndimor, të financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe inovacionet në Ballkanin Perëndimor. Është një iniciativë e re që synon të përmirësojë qasjen në financa për NVM në Ballkanin Perëndimor, duke ndihmuar në zhvillimin e ekonomisë lokale si dhe tregjet rajonale të kapitalit të rrezikshëm dhe në të njëjtën kohë të promovohen reformat e politikave për të mbështetur qasjen në financa, nëpërmjet instrumenteve të financiare inxhinierike.
	Fondi i inovacionit te ndërmarrjet Në vitin 2015, në Ballkanin Perëndimor u krijua një Fond për kapitalin e rrezikshëm prej 40 milionë eurosh për të siguruar financim për NVM që fillojnë ose janë në fazat e hershme të zgjerimit. Ai investon në NVM të duke filluar nga faza fillestare deri në fazën e hershme të rritjes, në sektor inovativ që tregojnë potencial të lartë për rritje, me fokus të veçantë në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Fondi përmban një fond të veçantë për kapitalin fillestar ("farë", ang. "seed"), i cili fokusohet ekskluzivisht në kompanitë në fazën "para farës " ose "farës".
Banka evropiane për rindërtim dhe zhvillim (BERZH)	BERZH synon të zhvillojë një klimë të shëndetshme të investimit dhe të promovojë një zhvillim të shëndoshë dhe të qëndrueshëm nga pikëpamja ekologjike dhe sociale. Mandati i tij është të nxisë tranzicionin drejt ekonomive të hapura të orientuara nga tregu dhe të promovojë iniciativën private dhe sipërmarrëse. BERZH udhëhiqet nga parimi që një ekonomi funksionale e tregut duhet të jetë konkurruese, gjithëpërfshirëse, e qeverisur mirë, ekologjike, fleksibile dhe e integruar. BERZH investon në projekte, shumica e tyre në sektorin privat, punon në reformat e politikave dhe ofron këshilla afariste, dhe e gjithë kjo nxit rritjen e qëndrueshme.
Banka për zhvllim e Këshillit të Evropës (CEB)	Banka për zhvillim e Këshillit të Evropës (CEB) është një bankë multilaterale zhvillimore me mandat social. Përmes sigurimit të financimit dhe ekspertizë teknike për projekte me ndikim të lartë social në vendet e saj anëtare, ajo promovon në mënyrë aktive kohezionin social dhe përforcon integrimin social në Evropë. CEB është instrumenti kryesor i politikës së solidaritetit në Evropë.
Banka gjermane për zhvillim (Kreditanstalt für	Banka gjermane për zhvillim (Kreditanstalt für Wiederaufbau, KfW) mbështet ndryshimin dhe nxit idetë e avancuara në RF të Gjermanisë, Evropë dhe në mbarë botën. Ajo ka një histori të afatgjate të trajtimit të nevojave zhvillimore në ekonomitë në tranzicion.

Wiederaufbau, KfW)	
Korniza e investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF)	Korniza e investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) u themelua në vitin 2009 si një iniciativë e përbashkët e Komisionit Evropian (KE), Bankës për zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB), Bankës evropiane për rindërtim dhe zhvillim (BERZH) dhe Bankës evropiane të investimeve (EIB). Banka e zhvillimit KfW (KfW) dhe Grupi i Bankës botërore (WBG) iu bashkuan platformës më pas. Në dhjetor të vitit 2018, Agjencia franceze për zhvillim (AFD) u bë një organizatë e re pjesëmarrëse në WBIF. WBIF është një instrument rajonal për financimin e kombinuar, qëllimi i të cilit është t'i përgjigjet nevojave të mëdha për investime në infrastrukturën e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe të mbështesë procesin e anëtarësimit në BE të përdoruesve: Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë. Ai ofron financim dhe asistencë teknike për investime strategjike në sektorët e mëposhtëm: energji, mjedis jetësor, social, transport, zhvillim të sektorit privat dhe infrastrukturë digjiitale.
Agence Française de Développement (AFD)	Agence Française de Développement (AFD) është një institucion financiar publik gjithëpërfshirës dhe një aktor kryesor në politikën e zhvillimit të Francës.
Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)	USAID udhëheq përpjekjet për zhvillim ndërkombëtar dhe përpjekjet humanitare të Shteteve të Bashkuara për të shpëtuar jetë, për të ulur varfërinë, për të përforcuar qeverisjen demokratike dhe për të ndihmuar njerëzit të avancojnë përtej ndihmës. Në emër të popullit amerikan, ajo promovon dhe demonstron vlerat demokratike jashtë vendit dhe përparon një botë të lirë, paqësore dhe të begatë.

Literatura e përdorur

Ang, Geraldine, Dirk Röttgers and Pralhad Burli (2017) The empirics of enabling investment and innovation in renewable energy environment. Working Paper no. 123. Paris: Organisation for Economic Cooperation and Development.

Berrada, Tony, Leonie Engelhard, Rajna Gibson, and Philipp Krueger (2022) "The economics of sustainability linked bonds", Swiss Finance Institute Research Papers, no. 22-26.

Chamon, Marcos and Paolo Mauro (2006) "Pricing growth-indexed bonds", *Journal of Banking & Finance*, 30 (12): 3349-3366.

Cheng, Gong, Torsten Ehlers, and Frank Packer (2022) "Sovereigns and sustainable bonds: challenges and new options", BIS Quarterly Review, September 2022, Basel: Bank for International Settlements.

Convergence (2017) *Impact Bonds in Developing Countries: Early Learnings from the Field*. Convergence and Center for Universal Education at Brookings.

European Commission (2022) *Investing in Sustainable Development – Progress Report 2018-2020.* Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2022.

Gallagher, Kevin and Lyuba Zarsky (2007) *The Enclave Economy*. Cambridge, MA: MIT Press.

Gelb, Stephen, Sona Kalantaryan, Simon McMahon, and Marta Perez-Fernandez (2021) Diaspora finance for development: From remittances to investment. JRC Technical Report, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2021.

IADB (2020) *Financial Innovation to Support Women-Led Businesses Mexico - Mexico's First Gender Bonds and the Role of National Development Banks.* Washington DC: Inter-American Development Bank.

IMF (2022) 2021 Article IV Consultation—Press Release; Staff Report; Staff Statement; and Statement by the Executive Director for the Republic of North Macedonia, IMF Country Report No. 22/47. Washington DC: The International Monetary Fund.

Lagoarde-Segot, Thoms (2020) "Financing the Sustainable Development Goals", *Sustainability* 2020, 12, 2775; doi:10.3390/su12072775.

Lukšić, Igor, Bojana Bošković, Aleksandra Novikova, and Rastislav Vrbensky (2022) "Innovative financing of the sustainable development goals in the countries of the Western Balkans", *Energy, Sustainability and Society* 12 (15): 1-19.

Mrak, Mojmir (2019) *North Macedonia: Fiscal Implications of EU Accession Driven Reform Processes*. Skopje: United Nations Development Programme.

OECD (2021) Global Outlook on Financing for Sustainable Development 2021 – A New Way to Invest for People and Planet. Paris: OECD.

Startup Genome (2020) *Save Your Startups: Using Policy to Kickstart the Post-Crisis Economy*. The Global Startup Ecosystem Report 2020.

UN (2019). *Financing for Sustainable Development Report.* New York: United Nations.

UN (2021). *SDG Financing Landscape in North Macedonia.* November 2021. Skopje: United Nations Resident Coordinator Office.

UNDP (2012) *Innovative Financing for Development: A New Model for Development Finance?* New York: United Nations Development Programme.

UNEP (2016) *Definitions and concepts – Background Note*. Inquiry Working Paper 16/13, United Nations Environment Programme.

UNDP (2022) National Development Strategy – Quarterly Update. Skopje: United Nations Development Programme.

WBIF (2020) *Western Balkans Investment Framework - A Guide*. Western Balkans Investment Framework, March 2020.

World Bank (2009) *Innovative Finance for Development Solutions*. Washington DC: World Bank Group.

World Bank (2021) *Assessment of the startup ecosystems in the Western Balkans*. Washington DC: The World Bank Group.

Zerbib, Olivier David (2016) "The effect of pro-environmental preferences on bond prices: Evidence from green bonds.", *Journal of Banking and Finance*, 98 (1): 39-60.